



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.96

2004

17 dhjetor

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9337
datë 16.12.2004

Për ratifikimin e “Marrëveshjes së kredisë për zhvillim ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për programin e fazës së tretë të kredisë, në mbështetje të uljes së varfërisë”..... 6591

Ligj nr.9338
datë 16.12.2004

Për disa ndryshime në ligjin nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”..... 6597

LIGJ
Nr.9337, datë 16.12.2004

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË KREDISË PËR ZHVILLIM NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA), PËR PROGRAMIN E FAZËS SË TRETË TË KREDISË, NË MBËSHTETJE TË ULJES SË VARFËRISË”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e kredisë për zhvillim ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për programin e fazës së tretë të kredisë, në mbështetje të uljes së varfërisë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4427, datë 16.12.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE KREDIE PËR ZHVILLIM
(Kredia e tretë në mbështetje të uljes së varfërisë)

Marrëveshje..... 200 ndërmjet Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar (Shoqata)

Meqenëse (A) Shoqata ka marrë nga Huamarrësi një letër të datës.....2004, që përshkruan programin e veprimeve, objektivave dhe politikave me qëllim zbutjen e varfërisë në territorin e Huamarrësit (tani e tutje quhet Programi), që deklaron përkushtimin e Huamarrësit për zbatimin e Programit dhe kërkon ndihmën e Shoqatës për të mbështetur programin gjatë zbatimit;

B) Huamarrësi ka realizuar masat dhe ka ndërmarrë veprimet e përshkruara në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje në një masë të kënaqshme për Shoqatën, si dhe ka ruajtur një kuadër politikash makroekonomike të pëlqyeshme për shoqatën;

C) në bazë, ndër të tjera, të pohimeve të mësipërme, Shoqata ka vendosur të mbështesë programin duke ndihmuar Huamarrësin përmes dhënies së kredisë siç përshkruhet në vijim, tashmë, palët bien dakord përsa vijon:

Neni 1
Kushtet e përgjithshme, përkufizimet

Seksioni 1.01 “Kushtet e përgjithshme për t’u zbatuar në Marrëveshjet e Kredisë për Zhvillim”, të shoqatës të datës 1 janar 1985 (ndryshuar në 1 maj 2004), me ndryshimet e përcaktuara më poshtë (Kushtet e përgjithshme), përbëjnë pjesën bazë të kësaj Marrëveshjeje:

a) Seksioni 2.01, paragrafi 12 ndryshohet për t’u lexuar:

“Projekt do të thotë programi, referuar në hyrje të Marrëveshjes së Kredisë së Zhvillimit në mbështetje të së cilës jepet kredia”;

Seksioni 4.01 ndryshohet për t’u lexuar:

“Përveçse kur Huamarrësi dhe Shoqata bien dakord ndryshe, tërheqjet nga llogaria e kredisë do të bëhen në monedhën e llogarisë së depozitës të përcaktuar në seksionin 2.02 të Marrëveshjes së Kredisë së Zhvillimit”;

c) Seksioni 5.01 ndryshohet për t’u lexuar:

“Huamarrësi ka të drejtë të tërheqë shumat e kredisë nga llogaria e kredisë në përputhje me kushtet e Marrëveshjes së Kredisë së Zhvillimit dhe të këtyre kushteve të përgjithshme”;

d) Fjalja e fundit e seksionit 5.03 hiqet;

e) Seksioni 9.06 (c) ndryshohet për t’u lexuar:

“ c) Jo më vonë se 6 muaj pas datës së mbylljes ose ndonjë datë e mëvonshme siç mund të bihet dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Shoqatës, Huamarrësi do të përgatisë dhe do t’i dërgojë Shoqatës një raport për këtë qëllim dhe në detaje siç e kërkon Shoqata, për zbatimin e programit referuar në hyrjen e Marrëveshjes së Kredisë së Zhvillimit, kryerjen e detyrimeve përkatëse prej Huamarrësit dhe Shoqatës sipas Marrëveshjes së Kredisë së Zhvillimit për përmbushjen e qëllimeve të kredisë”;

f) Seksioni 9.04 hiqet dhe seksionet 9.05, 9.06 (të ndryshuara më sipër), 9.07 dhe 9.08 do të numërohen përsëri, respektivisht, seksionet 9.04, 9.05, 9.06 dhe 9.07;

Seksioni 1.02 Përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe, disa terma të përcaktuara në kushtet e përgjithshme dhe në hyrjen e kësaj marrëveshjeje dhe termat plotësuese që pasojnë kanë kuptimet përkatëse të përcaktuara këtu më poshtë:

a) “Komunë” do të thotë një njësi administrative dhe territoriale dhe komuniteti i banorëve i përcaktuar në nenin 5 të ligjit mbi organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor (Ligji nr.8652, datë 31 korrik 2000).

b) “Llogaria e depozitës” do të thotë llogaria referuar seksionit 2.02 (b) të kësaj Marrëveshjeje;

c) “VF” do të thotë viti fiskal i Huamarrësit që fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti kalendarik;

d) “Viti shkollor 2003-2004” do të thotë viti akademik i Huamarrësit që fillon më 15 shtator 2003 dhe përfundon më 9 qershor 2004;

e) “Viti shkollor 2004-2005” do të thotë viti akademik i Huamarrësit që fillon më 20 shtator 2004 dhe përfundon më 16 qershor 2005.

Neni 2
Kredia

Seksioni 2.01 Shoqata pranon t’i japë Huamarrësit, sipas kushteve dhe termave të përcaktuara ose të përmendura në Marrëveshjen e Kredisë për Zhvillim, një shumë në valuta të ndryshme e barasvlefshme me ekuivalentin prej gjashtë milionë e nëntëqind mijë të drejta të posaçme tërheqjeje (SDR 6 900 000).

Seksioni 2.02 (a) Sipas kushteve të paragrafëve (b), (c) dhe (d) të këtij seksioni Huamarrësi ka të drejtë të tërheqë shumat e kredisë nga llogaria e kredisë që mbështet programin.

b) Huamarrësi përpara se të dërgojë te Shoqata kërkesën e parë për tërheqje nga llogaria e kredisë, do të hapë dhe mbajë një llogari depozite speciale në dollarë në bankën e tij qendrore me kushte dhe terma të pranueshme për Shoqatën. Të gjitha tërheqjet nga llogaria e kredisë do të depozitohen nga Shoqata në llogarinë e depozitës.

c) Huamarrësi merr përsipër të mos përdorë shumat e kredisë për të financuar shpenzimet e përjashtuara sipas kushteve të shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje. Nëse Shoqata përcakton në çdo kohë se një shumë e kredisë është përdorur për të paguar shpenzime të përjashtuara, menjëherë pas njoftimit nga ana e Shoqatës, Huamarrësi do të (i) depozitojë në llogarinë e depozitës një shumë të barabartë me shumën e pagesës së sipërpërmendur ose (ii) nëse Shoqata e kërkon, do të kompensojë Shoqatën për këtë shumë. Shumat që i kompensohen Shoqatës me kërkesën e vet do të kreditohen në llogarinë e kredisë për anulim.

Seksioni 2.03 Data e mbylljes është 31 dhjetor 2005 ose një datë e mëvonshme e përcaktuar nga Shoqata. Shoqata menjëherë do të njoftojë Huamarrësin lidhur me datën e mëvonshme.

Seksioni 2.04 (a) Huamarrësi do t'i paguajë Shoqatës në tarifë përkushtimi mbi shumën principale të kredisë së patërhequr herë pas here me një përqindje të caktuar nga Shoqata duke filluar më 30 qershor të çdo viti, por duke mos tejkaluar vlerën e një gjysmë përqindëshi (1/2 të 1%) në vit.

b) Tarifa e përkushtimit lind: (i) gjashtëdhjetë ditë nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje (data rrjedhëse) deri në datat respektive në të cilat shumat do të tërhiqen nga Huamarrësi nga llogaria e kredisë ose do të anulohen; dhe (ii) në përqindjen e caktuar më 30 qershor menjëherë para datës rrjedhëse ose me një interes tjetër që pastaj mund të përcaktohet sipas rastit në përputhje me paragrafin (a) më sipër. Interesi i caktuar më 30 qershor të çdo viti do të zbatohet nga data tjetër e të njëjtit vit të përcaktuar në seksionin 2.06 të kësaj Marrëveshjeje.

c) Pagesa e tarifës së përkushtimit do të kryhet: (i) në vende të tilla që shoqata në mënyrë të arsyeshme do të kërkojë; (ii) pa kufizime të çfarëdolloji që mund të imponohen nga, ose në territorin e Huamarrësit; dhe (iii) në monedhën e përcaktuar në këtë Marrëveshje për qëllimet e seksionit 4.02 të kushteve të përgjithshme ose në monedha të tjera të pranueshme që mund të përcaktohen ose të zgjidhen sipas rastit në përputhje me dispozitat e këtij seksioni.

Seksioni 2.05 Huamarrësi do t'i paguajë Shoqatës një tarifë shërbimi me një përqindje prej tre të katërtave të një përqindi (3/4 e 1%) në vit të shumës principale të kredisë së tërhequr dhe të papaguar sipas rastit.

Seksioni 2.06 Tarifat e përkushtimit dhe të shërbimit do të paguhet dy herë në vit më 15 prill dhe 15 tetor të çdo viti.

Seksioni 2.07 Huamarrësi do të shlyejë shumën principale të kredisë në këste 6 mujore çdo 15 prill dhe 15 tetor duke filluar nga 15 prilli 2015 dhe duke përfunduar më 15 tetor 2024. Çdo këst duhet të jetë 5 për qind (5%) e shumës principale.

Seksioni 2.08 Monedha e Shteteve të Bashkuara të Amerikës caktohet si monedha e përdorshme për qëllimet e seksionit 4.02 të kushteve të përgjithshme.

Neni 3 Kushte të veçanta

Seksioni 3.01 (a) Huamarrësi merr përsipër të zbatojë programin siç duhet për të siguruar se veprimet dhe politikat e miratuara sipas programit zbatohen:

b) Huamarrësi dhe Shoqata sipas rastit me kërkesë të çdonjërës palë do të shkëmbejnë mendime mbi ecurinë e arritur nga zbatimi i Programit.

c) Përpara çdo shkëmbimi mendimesh, Huamarrësi do t'i japë Shoqatës për të rishikuar dhe dhënë komente një raport, të detajuar siç mund ta kërkojë Shoqata, mbi ecurinë e arritur nga zbatimi i Programit.

d) Pa kufizime sipas kushteve të paragrafit (a) të këtij seksioni, Huamarrësi do të shkëmbejë mendime me Shoqatën mbi çdo veprim të propozuar për t'u ndërmarrë pas disbursimit të kredisë, që do të ndikonte në ndryshimin e objektivave të programit, ose mbi çdo veprim të ndërmarrë sipas programit.

Seksioni 3.02 Me kërkesë të Shoqatës, Huamarrësi:

a) do të auditojë llogarinë e depozitës, në përputhje me parimet e përshtatshme audituese të zbatueshme, nga auditorë të pavarur të pranueshëm për Shoqatën;

b) do t'i japë Shoqatës sa më shpejt, por në çdo rast jo më vonë se katër muaj (4) pas datës së kërkesës së Shoqatës për një auditim të tillë, një kopje të vërtetuar të raportit të auditimit nga auditorët e përmendur, për këtë qëllim dhe i detajuar siç ta kërkojë Shoqata;

c) t'i japë Shoqatës çdo informacion tjetër lidhur me llogarinë e depozitës dhe auditimin siç të kërkojë Shoqata.

Neni 4

Rrethana shtesë për pezullim

Seksioni 4.01 Sipas seksionit 6.02 (1) të kushteve të përgjithshme, rrethanë shtesë do të quhet dalja e një situatë që e bën të pamundur zbatimin e programit ose të një pjese të rëndësishme të programit.

Neni 5

Përfundimi

Seksioni 5.01 Periudha prej nëntëdhjetë ditësh (90) pas datës së kësaj Marrëveshjeje përcaktohet për qëllimet e seksionit 12.04 të kushteve të përgjithshme.

Neni 7

Përfaqësuesi i Huamarrësit, adresat

Seksioni 6.01. Ministri i Financave i Huamarrësit caktohet si përfaqësues i Huamarrësit për qëllimet e seksionit 11.03 të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 6.02 Adresat e mëposhtme janë përcaktuar për qëllimet e seksionit 11.01 të kushteve të përgjithshme.

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"

Tirana, Albania Faks: 35542 28495

Për shoqatën:

International Development Association

1818 H Street, N.W.

Washington, D.C. 20433

United States of America

Adresa telegrafike

Teleks Indevas 248423 (MCI) ose (202)477-

6391, Washington, D.C. 64145 (MCI)

Para dëshmitarëve, palët nënshkruese, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë rënë dakord që kjo Marrëveshje të nënshkruhet me emrat e tyre përkatës në Tiranë, Shqipëri, në datën dhe vitin e sipërshënuar për herë të parë.

Shqipëria

Nga Përfaqësuesi i Autorizuar

Shoqata për zhvillim ndërkombëtar

Nga Përfaqësuar i Autorizuar

SHTOJCA 1 SHPENZIMET E PËRJASHTUARA

Për qëllimet e seksionit 20.2 (c) të kësaj Marrëveshjeje, shumat e kredisë nuk do të përdoren për financimin e shpenzimeve të mëposhtme:

1. shpenzime në monedhën e Huamarrësit, ose për mallrat dhe shërbimet të furnizuara nga territori i Huamarrësit;

2. shpenzime për mallra ose shërbime të furnizuara sipas një kontrate të financuar nga ndonjë institucion financiar kombëtar ose ndërkombëtar ose agjenci të ndryshme nga Banka ose Shoqata, ose për të cilën Shoqata ose banka kanë financuar ose kanë rënë dakord për të financuar një kredi ose hua tjetër:

3. shpenzime për mallrat të përfshira në grupet apo nëngrupet e mëposhtme të klasifikimit standard të tregtisë ndërkombëtare, rishikimi 3 (S.I.T.C Rish,3), të publikuara nga statistikat e Kombeve të Bashkuara, Seritë M, Nr.34/Rish3 (1986) (SITC), ose në çdo grup ose nëngrup pasues sipas rishikimeve të ardhshme të SITC, të pëcaktuara nga Shoqata dhe të njoftuara Huamarrësit:

Grupi	Nëngrupi	Përshkrimi
112	-	Pije alkoolike
121	-	Tobako, të parafabrikuara tobako të refuzuara
122	-	Tobako të fabrikuara (që përmbajnë ose jo zëvendësues të tobakos)
525	-	Materiale radioaktive dhe të ngjashme
667	-	Gurë të çmuar, perla dhe gjysmë të çmuara të papunuara ose të punuara
718	718,7	Reaktorë nuklearë dhe pjesë të tyre, elemente djegëse, jo-rrezatuese, për reaktorët nuklearë
728	728.43	Makineri të përpunimit të tobakos
897	897.3	Bizhuteri prej floriri, metale prej argjendi ose platin (përveç orëve dhe kutive të orëve) dhe mallrave të arpunuesve dhe argjendpunuesve
971	-	Ar, jomonetar (duke përjashtuar mineralet prej floriri dhe përqëndrimet)

4. shpenzime për mallrat për qëllimet ushtarake ose paraushtarake ose për konsumin e mallrave luksoze;

5. shpenzime për mallrat e rrezikshme për mjedisin (për qëllimet të këtij paragrafi termi “mallra të rrezikshme për mjedisin” do të thotë mallra, prodhimi, përdorimi ose importimi i të cilave është i ndaluar sipas ligjeve të Huamarrësit ose marrëveshjeve ndërkombëtare pjesë e të cilave është edhe huamarrësi);

6. shpenzime në llogaritë e pagesave për personat ose njësi, ose çdo importim i mallrave, nëse pagesa ose importe të tilla janë të ndaluara me anë të një vendimi të Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara sipas kapitullit 7 të Kartës së Kombeve të Bashkuara;

7. shpenzime sipas një kontrate lidhur me të cilën Shoqata përcakton se janë përdorur praktika korruptuese ose mashtruese, nga përfaqësuesit e Huamarrësit ose nga një përfitues i kredisë gjatë prokurimit ose zbatimit të kësaj kontrate, pa u marrë masat kundërvepruese të duhura dhe në kohën e përshtatshme nga ana e Huamarrësit dhe të pëlqyeshme për Shoqatën.

SHTOJCA 2
PROGRAMI I VEPRIMEVE TË NDËRMARRA NGA HUAMARRËSI

1. Huamarrësi ka ruajtur një kuadër makroekonomik të pëlqyeshëm.
2. Huamarrësi (a) ka përfunduar regjistrimin fillestar të tokës në masën 80% të zonave kadastrale; dhe (b) ka zbatuar masat për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeje të mundshme lidhur me regjistrimin fillestar në territorin e Huamarrësit.
3. Huamarrësi ka rritur buxhetin e alokuar për sektorin e shëndetësisë për vitin fiskal 2004 në terma realë krahasuar me vitin fiskal 2003 për: (a) programet e planifikuara të shëndetit publik; dhe (b) shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes për kujdesin parësor, të cilat do t'i jenë: (i) transferuar pushtetit vendor si grant i kushtëzuar ose (ii) të financuara nëpërmjet mekanizmave alternativë të pranueshëm për Shoqatën, duke siguruar në këtë mënyrë financim të përshtatshëm për veprimet e kujdesit shëndetësor parësor.
4. Huamarrësi ka rritur buxhetin e alokuar për sektorin e arsimit në vitin fiskal 2004 në terma realë krahasuar me vitin fiskal 2003 për shpenzimet e pagave dhe shpenzimet e tjera, përveç pagave.
5. Huamarrësi ka:
 - a) zbatuar një politikë të pëlqyeshme të librave falas për arsimin bazë për vitin shkollor 2003-2004;
 - b) pasur ecuri të kënaqshme në vazhdimin e zbatimit të politikës së librave falas për arsimin bazë për vitin shkollor 2004-2005;
 - c) pasur ecuri të kënaqshme në zbatimin e masave për të siguruar libra falas për arsimin dytësor në 80 komunat më të varfëra të zgjedhura brenda territorit të Huamarrësit për vitin shkollor 2004-2005.
6. (a) Dekretimi i Amendimit (ligji nr.9114, datë 24 dhjetor 2003) i ligjit të Huamarrësit nr.7703, datë 11 maj 1993 për sigurimet shoqërore, dhe Huamarrësi ka pasur ecuri të kënaqshme në zbatimin e tij lidhur me kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare të Institutit të Sigurimeve Shoqërore të Huamarrësit nga një auditor i jashtëm i pavarur i kualifikuar.
- b) Huamarrësi ka pasur ecuri të kënaqshme për zbatimin e amendamendeve të ligjit të Huamarrësit nr.7703, datë 11 maj 1993 për sigurimet shoqërore lidhur me rritjen në fazë të moshës së daljes në pension dhe uljes së përfitimeve për ata persona që dalin në pension para kohe.
7. Huamarrësi ka siguruar evidencë të kënaqshme lidhur me caktimin ose pezullimin e personave në pozicione kyçe, të cilat janë në përputhje me objektivat e legjislacionit përkatës, si dhe me parimet e Kodit të Etikës së Huamarrësit (ligji nr.9131, datë 8 shtator 2003).
8. Huamarrësi ka përgatitur dhe publikuar pasqyrat e audituara të konsoliduara financiare të llogarive të buxhetit për vitin fiskal 2002 të ministrive, Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe pushtetit vendor dhe ka pasur ecuri të kënaqshme në zbatimin e masave për të përmirësuar cilësinë në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit publik, që është e pranueshme për Shoqatën.
9. Huamarrësi ka miratuar një set të plotë të akteve nënligjore për zbatimin e ligjit nr.7971, datë 26 korrik 1995 për prokurimet dhe ka miratuar dhe publikuar dokumentet standarde të tenderimit dhe një manual përdorimi për prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve, të pëlqyeshme për Shoqatën.
10. Huamarrësi ka miratuar letrat e politikave në shëndetësi, arsim dhe ndihmë sociale dhe anekset e tyre teknike, të pëlqyeshme për Shoqatën, të cilat shtjellojnë: (a) përgjegjësitë specifike të pushtetit vendor lidhur me funksionet e ndara dhe (b) një plan veprimi që përcakton standardet bazë minimale kombëtare dhe indikatorët e performancës për vlerësimin e shërbimeve të ofruara nga pushtetit vendor.

LIGJ
Nr.9338, datë 16.12.2004

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9267, DATË 29.7.2004 “PËR
VEPRIMTARINË E SIGURIMIT, TË RISIGURIMIT DHE NDËRMJETËSIMIT NË
SIGURIME DHE RISIGURIME”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në pikën 2 të nenit 6, rreshti i dytë, pas fjalëve “shoqëritë e huaja risiguruese” shtohen fjalët “të miratuara nga Autoriteti,”.

Neni 2

Në fund të pikës 2 të nenit 57 shtohen fjalët “duke përfshirë edhe kërkesat e përshtatshmërisë ligjore dhe teknike të pjesëmarrjes influencuese”.

Neni 3

Shkronja “a” e pikës 1 të nenit 62 shfuqizohet.

Neni 4

Shkronja “b” e nenit 64 shfuqizohet.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4428, datë 16.12.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare;

Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Tel: 042 555 63; 267 468

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
11.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
2.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË	1500
5.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500

DOLI NGA SHTYPI

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	1500
TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	2000

Doli nga shtypi më 17.12.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2004

Çmimi 100 lekë